



Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës  
**IHK "INFRAKOS" Sh.A. – Fushë Kosovë**

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**  
**DHE PASQYRAT FINANCIARE**  
Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2018

Prishtinë, Mars 2019

## **Përmbajtja**

|                                                             |    |
|-------------------------------------------------------------|----|
| Informatat e përgjithshme.....                              | 3  |
| Raporti i auditorit të pamvarur.....                        | 4  |
| Pasqyra e Pozitës financiare .....                          | 7  |
| Pasqyra e të Ardhurave.....                                 | 8  |
| Pasqyra e ndërrimeve të ekuitetit.....                      | 9  |
| Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme.....                | 10 |
| Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin 2018 .....       | 11 |
| Përmbledhja e politikave domethënëse të kontabilitetit..... | 14 |
| Shtojcë: PF te pergaditura sipas UA 2/2013 të MF.....       | 29 |

## Informata të Përgjithshme

### Organet e Ngarkuara me Qeverisjen:

- z. Enver Aruqaj, Kryetar i Bordit
- z. Nijazi Selmani, Drejtor jo Ekzekutiv
- z. Fëllënëza Xhelili, Drejtor jo Ekzekutiv,
- z. Milazim Bytyqi, Drejtor jo Ekzekutiv

### Menaxhmenti:

Agron Thaçi – Kryeshef Ekzekutiv

Xhevat Ramosaj – Zv. Kryeshef Ekzekutiv

Zymer Zukaj – Zyrtar Kryesor Financiar

Adresa:

Sheshi i Lirisë pn.

12000 Fushë Kosovë.

Banka Koresponduese:

ProCredit Bankë,

Auditorë:

Kompania e Licencuara "H&N" Sh.p.k

Rruga Ilaz Kodra nr.29

10000 Prishtinë, Kosovë

**Kontakti: [auditimit@gmail.com](mailto:auditimit@gmail.com),**

**Tel: 038 / 541 144**

Drejtimi-Menaxhmenti





## RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

Për: Organet e Ngarkuara me Qeverisjen dhe Drejtimin e Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "INFRAKOS" SHA, Sheshi i Lirisë p.n. 12000 Fushë Kosovë, Kosovë dhe të interesuarit tjerë.

### Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

#### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të IHK "INFRAKOS" SH.A., me adresë: Rruga "Sheshi i Lirisë" pn, Fushë Kosovë të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

*Sipas opinionit tonë*, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për), pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2018, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.



Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arësyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.



Nga çështjet e komunikuara personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për pasojë edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në raste jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arësye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

#### **Çështjet Kryesore të theksuara**

- Parimi i Vijimësisë- Testimet tona kanë vërejtur se edhe për ushtrimin nën auditim kompania ka pasë vështëresi afariste çka ka rezultuar te afaroj me rezultat negativ financiar (humbje). Ende Aksionari dhe Ministria e Infrastrukturës e Republikës së Kosovës nuk kanë arritë që në plotëni të përmbushin obligimet financiare. Po ashtu ende nuk janë përmbushë kërkesat e nenit 63 pika 3 të Ligjit nr 04/L-063 Për Hekurudhat e Kosovës për vendosjen e marrëveshtjes kontraktuale në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe “Infrakos” Sha.
- Siç është shpalosur në Shënimin 4- Aktivet materiale afatgjata, testimet tona kanë vërejtur se kompania nuk ka bërë rivlerësim të aktiveve materiale të saja siç janë toka,ndertesa, infrastruktura e hekurudhës dhe paisjet që nga viti 2005 që është një periudhë e gjatë kohore. Ne nuk kemi siguri se aktivet materiale janë paraqitur me vlerën e drejtë për ushtrimin nën auditim.Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16-Aktivët materiale kërkon që nëse vlera e drejtë e një aktivi ndryshon materialisht nga vlera e tij kontabël (neto), është i nevojshëm një rivlerësim i mëtejshëm.

Me respekt,

Kompania Audituese

“H&N” SH.P.K.

Rruga Ilaz Kodra nr.29  
10000 Prishtinë, Kosovë  
27 Shkurt 2019



# IHK "INFRAKOS" SHA-FUSHË KOSOVË

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2018

|                                          |        | Më 31 dhjetor 2018<br>(në 000 EUR) | Më 31 dhjetor 2017<br>(në 000 EUR) |
|------------------------------------------|--------|------------------------------------|------------------------------------|
|                                          | Shënim |                                    |                                    |
| <b>PASURITË JO QARKULLUESE</b>           |        |                                    |                                    |
| Toka                                     | 4      | 10,552                             | 10,552                             |
| Objektet ndërtimore                      | 4      | 6,947                              | 7,054                              |
| Pajisjet dhe makineritë                  | 4      | 2,267                              | 1,607                              |
| <b>Gjithsejt pasuritë jo qarkulluese</b> |        | <b>19,766</b>                      | <b>19,213</b>                      |
| <b>PASURITË QARKULLUESE</b>              |        |                                    |                                    |
| Stoqet                                   | 5      | 838                                | 869                                |
| Llogaritë e arkëtueshme                  | 6      | 2,927                              | 2,469                              |
| Paraja në arkë dhe Bankë                 | 7      | 41                                 | 627                                |
| <b>Gjithsejt pasuritë qarkulluese</b>    |        | <b>3,806</b>                       | <b>3,966</b>                       |
| <b>GJITHSEJT PASURITË</b>                |        | <b>23,572</b>                      | <b>23,179</b>                      |
| <b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>            |        |                                    |                                    |
| <b>DETYRIMET AFATSHKURTËRA</b>           |        |                                    |                                    |
| Llogaritë e pagueshme tregtare           | 9      | 1,650                              | 612                                |
| Obligimet për tatime dhe contribute      | 9      | 765                                | 223                                |
| Obligimet tjera afatshkurta              | 9      | 205                                | 205                                |
| <b>Gjithsejt detyrimet afatshkurta</b>   |        | <b>2,620</b>                       | <b>1,040</b>                       |
| <b>DETYRIMET AFATGJATA</b>               |        |                                    |                                    |
| Grantet e shtyra qeveritare              | 10     | 7,904                              | 8,188                              |
| Detyrimet e shtyra tatimore              | 10     | 258                                | 395                                |
| <b>Gjithsejt detyrimet afatgjata</b>     |        | <b>8,162</b>                       | <b>8,583</b>                       |
| <b>GJITHSEJT DETYRIMET</b>               |        | <b>10,782</b>                      | <b>9,623</b>                       |
| <b>KAPITALI AKSIONAR DHE EKUITETI</b>    |        |                                    |                                    |
| Kapitali aksionar                        | 8      | 25                                 | 25                                 |
| REZERVAT E RIVLERËSIMIT                  | 8      | 15,227                             | 15,227                             |
| FITIMET/HUMBJET E BARTURA                | 8      | -1,697                             | -1,606                             |
| FITIMI APO HUMBJA E PERIUDHES            | 8      | -765                               | -90                                |
| <b>GJITHSEJT KAPITALI DHE REZERVAT</b>   |        | <b>12,790</b>                      | <b>13,556</b>                      |
| <b>GJITHSEJT DETYRIMET DHE EKUITETIT</b> |        | <b>23,572</b>                      | <b>23,179</b>                      |

Kryeshefi Ekzekutiv  
Agron Thaqi

Zyrtari Kryesor Financiar  
Zymer Zekaj

Shënimet nga numri 1 deri në numrin 18 janë pjesë përbërse e këtyre Pasqyrave Financiare.



## IHK "INFRAKOS" SHA-FUSHË KOSOVË

### Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2018

|                                   |           | Për fund vitin 31<br>dhjetor 2018<br>(në 000 EUR) | Për fund vitin 31<br>dhjetor 2017<br>(në 000 EUR) |
|-----------------------------------|-----------|---------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| Shenimi                           |           |                                                   |                                                   |
| <b>TË HYRAT</b>                   |           |                                                   |                                                   |
| Të hyrat nga shitja               | 11        | 1,350                                             | 1,463                                             |
| Të hyrat tjera afariste           | 11        | 587                                               | 1,334                                             |
| Të hyrat shtyra                   | 11        | 915                                               | 950                                               |
| Kosto                             |           | 0                                                 | 0                                                 |
| <b>Bruto fitimi</b>               |           | <b>2,851</b>                                      | <b>3,747</b>                                      |
| <b>SHPENZIMET</b>                 |           |                                                   |                                                   |
| Pagat dhe meditet bruto           | 12        | -2,004                                            | -2,027                                            |
| Kontributi për sig.pens/Punëdhën. | 12        | -100                                              | -101                                              |
| Shpenzimet e Zhvlerësimit         | 12        | -1,109                                            | -1,137                                            |
| Shpenzimet tjera                  | 12        | -324                                              | -373                                              |
| Shpenzimet tjera afariste         | 12        | -79                                               | -197                                              |
|                                   |           | <b>-3,616</b>                                     | <b>-3,837</b>                                     |
| <b>FITIMI /HUMBJA OPERATIVE</b>   | <b>13</b> | <b>-765</b>                                       | <b>-90</b>                                        |
| Shpenzimet financiare             |           | 0                                                 | 0                                                 |
| <b>FITIMI/HUMBJA PA TATIMIT</b>   |           | <b>-765</b>                                       | <b>-90</b>                                        |
| Tatimi në fitim                   |           | 0                                                 | 0                                                 |
| <b>Fitimi/(Humbja) neto</b>       |           | <b>-765</b>                                       | <b>-90</b>                                        |

Kryeshefi Ekzekutiv  
Agron Thaqi



Zyrtari Kryesor Financiar  
Zymer Zekaj

## "INFRAKOS" SHA-FUSHË KOSOVË

### *Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet*

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2018

|                                   | Kapitali<br>aksionar<br>000 EUR | Rezervat<br>000 EUR | Fitimi i<br>bartur<br>000 EUR | Gjithsejt<br>ekuiteti<br>000 EUR |
|-----------------------------------|---------------------------------|---------------------|-------------------------------|----------------------------------|
| <b>Bilanci me 01 Janar 2017</b>   | <b>25</b>                       | <b>15,227</b>       | <b>-1,606</b>                 | <b>13,645</b>                    |
| Rivlerësimi                       |                                 | 0                   |                               | 0                                |
| Ftimi/ humbja e periudhës         |                                 |                     | -90                           | -90                              |
| <b>Bilanci me 31 dhjetor 2017</b> | <b>25</b>                       | <b>15,227</b>       | <b>-1,697</b>                 | <b>13,556</b>                    |
| <b>Bilanci me 01 Janar 2018</b>   | <b>25</b>                       | <b>15,227</b>       | <b>-1,696</b>                 | <b>13,556</b>                    |
| Rivlerësimi                       |                                 |                     |                               |                                  |
| Ftimi/ humbja e periudhës         |                                 |                     | -765                          | -765                             |
| <b>Bilanci me 31 dhjetor 2018</b> | <b>25</b>                       | <b>15,227</b>       | <b>-2,462</b>                 | <b>12,790</b>                    |

Kryeshefi Ekzekutiv  
Agron Thaqi




Zyrtari Kryesor Financiar  
Zymer Zekaj





## "INFRAKOS" SHA-FUSHË KOSOVË

### Pasqyra e rrjedhës së parashë

Për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2018

| Shenimi                                                    | Për fund vitin<br>31 dhjetor 2018<br>(në000 EUR) | Për fund vitin 31<br>dhjetor 2017<br>(në 000 EUR) |
|------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| <b>AKTIVITETET OPERATIVE</b>                               |                                                  |                                                   |
| Arkëtimet e parashë nga blerësit                           | 1,595                                            | 1,963                                             |
| GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASHË NGA AO                        | <u>1,595</u>                                     | <u>1,963</u>                                      |
| Pagesat e parashë për furnitorët                           | -376                                             | -190                                              |
| Pagesat e parashë për të punësuarit                        | -1762                                            | -1793                                             |
| Pagesat e parashë për tatime                               | -43                                              | 0                                                 |
| GJITHSEJT PAGESAT E PARASHË PËR AO                         | <u>-2,181</u>                                    | <u>-1,983</u>                                     |
| <b>RRJEDHA NETO E PARASHË NGA AO</b>                       | <u><b>-586</b></u>                               | <u><b>-20</b></u>                                 |
| <b>AKTIVITETET INVESTIVE</b>                               |                                                  |                                                   |
| Arkëtimet tjera të parashë nga AI                          | 799                                              | 335                                               |
| GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASHË NGA AI                        | <u>799</u>                                       | <u>335</u>                                        |
| Pagesa tjera të parashë për AI                             | 799                                              | 335                                               |
| GJITHSEJT PAGESAT E PARASHË PËR AI                         | <u>799</u>                                       | <u>335</u>                                        |
| <b>RRJEDHA NETO E PARASHË NGA AI</b>                       | 0                                                | 0                                                 |
| <b>AKTIVITETET FINACUESE</b>                               |                                                  |                                                   |
| Arkëtimet tjera të parashë nga AF                          |                                                  | 578                                               |
| GJITHSEJ ARKËTIMET E PARASHË NGA AF                        | 0                                                | <u>578</u>                                        |
| <b>RRJEDHA NETO E PARASHË NGA AF</b>                       | 0                                                | 578                                               |
| <b>RRJEDHA NETO E PARASHË DHE EKUIVALENTEVE TË PARASHË</b> | -586                                             | 559                                               |
| <b>PARATË NË FILLIM TË PERIUdhËS</b>                       | 627                                              | 68                                                |
| <b>PARATË NË FUND TE PERIUdhËS</b>                         | <u><b>41</b></u>                                 | <u><b>627</b></u>                                 |

Kryeshefi Ekzekutiv  
Agron Thaqi



Zyrtari Kryesor Financiar  
Zymer Zekaj

## **IHK "INFRAKOS" SHA**

### **Shënimet për pasqyrat financiare, për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2018**

(Të gjitha shumat janë në 000 euro)

#### **1. Të përgjithëshme**

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. (INFRAKOS) ka filluar të veprojë si kompani në Shtator të vitit 2011 si pasuese e Hekurudhave të Kosovës Sh.A.

Vija e parë hekurudhore në Kosovë u ndërtua në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Infrakosi i menaxhon dhe mirëmban 333 km të linjave ekzistuese hekurudhore, 105 kilometra në stacione dhe mbi 100 kilometra linja industriale, sistemet e sinjalizimit, sistemet e komunikimeve, sistemet e energjetikës, 32 stacione hekurudhore, 115 ura me gjatësi prej 2988 metrash, 23 tunele me gjatësi prej 9020 metrash, 759 lëshesa dhe 257 vendkalime në nivel, si dhe ndërtesa tjera dhe pronën tokësore.

Shoqërinë Aksionare "Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës SH.A." me numër të biznesit 70325327, e cila është përgjegjëse për asetet, pronën, dhe gëzon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin si pasojë e këtij transformimi.

Linja kryesore lidhet në kufirin verior, në veri të Mitrovicës në Han të Elezit dhe në kufi me Maqedoninë përmes Fushë Kosovës afër Prishtinës. Kjo linjë ka gjatësi prej 141 km dhe është pjesë e Rrjetit hekurudhor qendror të SEETO-s (Observatori i Transportit i Evropës Juglindore) Rruga 10 që lidhë Shkupin me korridoret VIII dhe X të SEETO-s.

Linjat tjera përfshijnë Fushë Kosovë-Pejë, Klinë-Prizren (Klina gjendet në linjën mes Fushë Kosovës dhe Pejës) dhe Fushë Kosovë-Prishtinë-Podujevë. Disa nga këto linja nuk janë në funksion, sidomos ato që shkojnë në drejtim të kufirit me Serbinë dhe janë në shërbim të qyteteve të rëndësishme si p.sh. Podujevës, dhe linja që ofron shërbimin në Prizren.

Nuk ka lidhje hekurudhore direkte në mes të Kosovës në njëerën anë me Mali të Zi dhe Shqipërisë në anën tjetër.

Infrakosi është duke u ballafaquar me gjendjen jo të mirë të infrastrukturës dhe pamundësinë për funksionalizimin e plotë të saj. Nga ana tjetër kjo ndërmarrje ka disa përparësi që e veçojnë, ndër kryesoret është se ofron qasje në binar si i vetmi operator në territorin e Kosovës, pastaj mundësia e kyçjes në binar industrial në pjesën më të madhe të minierave në Kosovë dhe është linjë lidhëse hekurudhore me vendet fqinje.

#### **Emri dhe selia e Kompanisë**

Emri i Kompanisë është Infrastruktura e Hekurudhuvave të Kosovës "INFRAKOS" Sh.A. – Fushë Kosovë. Selia e Kompanisë është në Fushë Kosovë: "Sheshi i Lirisë" p.n., ku kompania i ka zyrat qendrore.

#### **1.2. Kapitali i Kompanisë**

Kapitali fillestar i Kompanisë me rastin e konstituimit ishte prej 25 mijë Euro.



## **Veprimtaria e Kompanisë**

Kompania si entitet ekonomik vepron në veprimtaritë ekonomike siç janë:

Fushëveprimi kryesorë i kompanisë është: Menaxhimi, mirëmbajtja, renovimi, përmirësimi dhe ndërtimi i infrastrukturës hekurudhore (linjave hekurudhore, stabilimenteve sinjalo-siguruese, stabilimenteve telekomunikuese, stabilimenteve të energjetikës, objekteve të stacioneve dhe objekteve tjera për ofrimin e shërbimeve) ofrimi i shërbimeve në терминаlet e mallrave, menaxhimi, mirëmbajtja, renovimi, ndërtimi dhe dhënia në shfrytëzim e pronës dhe objekteve të Infrastruktura hekurudhore për përfitime komerciale, menaxhimin e trafikut hekurudhor nëpër të gjitha linjat hekurudhore të Kosovës dhe pjesët e linjave të cilat e lidhin Kosovën me shtetet fqinje, si dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve tjera të nevojshme për të gjitha ndërmarrjet hekurudhore (operatorët me trenat).

Shërbimet të cilat i ofron kjo kompani kanë të bëjnë me:

Veprimtaria primare:

- 910 Transporti hekurudhor nderurban i pasagjerëve,

Veprimtaritë sekondare:

- Qasja në infrastrukturën hekurudhore që është shërbimi kryesor që ofron kjo kompani dhe aktualisht shërbimet me qasje në rrjet i ofrohen vetëm kompanisë Trainkos, ndërsa përveç kësaj ofron edhe
- Shërbimet e ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave përmes Terminalit të mallrave ;
- Dhënie me qira të tokave, banesave dhe lokaleve afariste përmes sektorit të patundshmërisë; dhe
- Ndërtimin e binarëve industrial.

### **1.3. Personeli i Kompanisë**

Gjat vitit ushtrimor Janar Dhjetor 2017 Kompania kishte mesatarisht 323 të punësuar, gjersa gjatë vitit ushtrimor Janar - Dhjetor 2018 kishte mesatarisht 316 të punësuar.

## **2. Politikat Kontabile**

Politikat bazë për hartimin dhe përgatitjet e “Pasqyrave financiare” janë si në vijim:

### **2.1 Baza e përgatitjes**

Keto “Pasqyra financiare” janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas Parimit të kostos historike, gjerësisht janë modifikuar në paraqitjen e Aktiveve Afatgjata (Prona, Ndërtesat dhe Paisjet) gjatë vlerësimeve të vitit 2005 dhe të cilat janë paraqitur me vlerat e rivlerësuar siq janë përshkruar edhe në shënimin që pason.



Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Parimin e vijimësisë sipas së cilit Kompania do të vazhdoi vijueshmërinë e aktiviteteve të veta edhe në të ardhmen. Operacionet e Kompanisë po ashtu janë të varuara dhe të mbështetura nga grantet dhe fonde të ndryshme Qeveritare. Përgatitja e Pasqyrave financiare në pajtim me SNRF-të kërkon përdorimin e vlerësimeve të

shpeshta e kritike të parametrave kontabël. Gjithashtu kërkojnë nga menaxhmenti të ushtroi gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave kontabël.

Të gjitha këto vlerësime janë bazuar në njohuritë dhe ngjarjet e tanishme dhe veprimet më të mira të menaxhmentit, rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të planifikuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin ushtrimor që përfundon me 31.12. 2018. Të dhënat krahasuese në bilancin e gjendjes janë ato të datës 31.12. 2017.

## **2.2. Adaptimi i Standardeve të reja dhe të reviduara**

a) Standardet dhe interpretimet që hyjnë në fuqi në periudhën e tanishme

Ndryshimet si në vijim për standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (IASB) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit:

- SNRF 1 “Përmirësimet vjetore në SNRF-të periudha 2014-2016” (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2018).
- SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2018),
- SNRF 15 “Të ardhurat nga Kontratat dhe Klientët” dhe ndryshimet e mëtejshme (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2018,
- Interpretimi 22 “Transaksionet dhe paradhëniet në monedhë të huaj” (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2018),
- Ndryshimet në SNRF 2 “Pagesat me bazë Aksionin” – Klasifikimi dhe Matja e Aksioneve - baza e Pagesës së transaksionit (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2018),
- Ndryshimet në SNK 40 “Aktivë afatgjatë material i investuar”( hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2018),

Adaptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka ndikuar në ndonjë ndryshim të pasqyrave financiare të Kompanisë.

b) Standardet dhe interpretimet që nuk hyjnë në fuqi në periudhën e tanishme

- SNRF 16 “Qiratë” (hyn në fuqi në periudhën vjetore që fillon më apo pas 1 janar 2019),
- Ndryshimet në IFRS 10 “Pasqyrat e Konsoliduara Financiare” dhe IAS 28 “Investimet në Ortakëri dhe Sipërmarrje të Përbashkët” – Shitja apo Kontributi i Pasurisë në mes të Investitorit dhe Ortakërisë apo Sipërmarrjes së Përbashkët dhe ndryshime të mëtejshme (data e hyrjes në fuqi shtyhet në një afat të pacaktuar derisa të projekti kërkimor për metodën e ekuitetit përfundon).



Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre ne fuqi. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e zbatimit fillestar.

### 2.3. Transaksionet në valutën e huaj

Transaksionet në valutën e huaj janë të shëndrruara në vlerën monetare raportuese respektivisht në euro, duke përdorur shkallën aktuale të këmbimit valuator për secilin transaksion të ndodhur. Fitimi ose humbja si rezultat i këtyre këmbimeve valutore nga transaksionet e ndodhura janë të njohura dhe të pasqyruara ne “Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve”.

### 2.4. Aktivët Afatgjatë (Toka, Ndërtesat, Infrastruktura e hekurudhës dhe Paisjet)

Zërat që pasqyrojnë Tokën, Ndërtesat,Infrastrukturën hekurudhore dhe Paisjet pasqyrojnë vlerat e këtyre aktiveve afatgjatë të cilat janë të rivlerësuara nga vlerësuesit e pavarur në vitin 2005, minus zhvlerësimet e akumuluar përkatëse.Gjithë efekti i rivlerësimit të aktiveve është vendosur edhe në llogarinë e kapitalit.Të gjitha aktivet tjera afatgjatë të blera apo te krijuara gjatë periudhes raportuese janë të paraqitura sipas koston minus zhvlerësimet e akumuluar. Kosto në këtë rast paraqet tërë shpenzimin që i përket përvetësimit (blerjes) të njësive (zërave). Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të aktivit apo është njohur si aktiv i veçant në mënyrë të duhur, vetëm atëherë kur përfitimet ekonomike të mundëshme lidhur me këtë mund të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera që nuk e shtojnë jetëgjatësinë e mjetit ngarkohen në shpenzime të periudhes konkretisht në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Toka si aktiv afatgjatë nuk është i zhvlerësueshëm, gjerësa të gjitha pasuritë tjera zhvlerësohen me metodën drejtëvizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivlerësuara mbi jetën e përdorimit të parashikuar siq vijonë:

- Ndërtesat me normen prej..... 5%
- Infrastruktura e hekurudhës.....5%
- Pajisjet dhe makineria ..... 10%
- Paisjet tjera, kompjuter e paisje zyrës me normen prej ..... 20%

### 2.5. Dëmet e Pasurive jo financiare

Pasuritë të cilat kanë jetë përdorimi të pa definuar nuk janë subjekt i zhvlerësimit dhe për ç’do vit testohen dëmet e tyre. Pasuritë të cilat janë subjekt zhvlerësimi janë rishikuar për dëmet kurdo që ndodhin ose në rrethanat të cilat e shtyejnë që vlera bartëse nuk mund të rikuperohen. Humbjet nga dëmet janë njohur për vlerën të cilën e kalon vlerën e rikuperueshme të vlerës bartëse të pasurisë. Kur vlera e rikuperimit e një pasurie është më e madhe se vlera fer, apo kosto më e vogël neto e shitjes vlera e rikuperimit mirret si vlerë në përdorim. Pasuritë jo financiare të cilat janë dëmtuar janë rishikuar për mundësi pezullimi të dëmeve në secilën datë raportimi.

### 2.6. Pasuritë financiare

#### 2.7. Pasuritë financiare klasifikohen në kategorit e specifikuar vijuese:

- A.) mjetet financiare në vlerën reale për mes fitimit ose humbjes.
- B.) kreditë dhe të arketueshmet. të gatshmet për shitje.



Klasifikimi varet në natyrën dhe qëllimin e mjeteve financiare që janë përvetësuar. Menaxhmenti e përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në njohjen fillestare deri në datën e bilancit të gjendjes. Kompanija nuk ka pasuri të klasifikuara në kategoritë e vlerës reale përmes fitimit apo humbjes të gatëshme për shitje. Blerjet dhe shitjet e pasurive financiare njihen në datën e tregtimit që d.m.th data kur Kompania zotron blerjen apo shitjen. Kreditë dhe të arketueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktuara që nuk janë kuotuar në një treg aktiv. Të njëjtat janë të përfshira në pasuritë rrjedhëse, përveq maturimit si pasuri jo-rrjedhëse. Kreditë dhe të arketueshmet e Kompanisë përbëhen prej të arketueshmeve tregtare të tjera dhe si dhe prej parasë dhe ekuivalentëve të parasë në bilancin e gjendjes.

## **2.8. Të arketueshmet e tjera dhe tregëtare**

Të arketueshmet tjera dhe tregëtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe më pas të matura me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interest minus provizionimi për dëme. Provizioni për dëmet e të arketueshmeve tregëtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme që Kompania nuk do të jetë në gjendje t'i mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të të arketueshmeve. Vështëresitë e mëdha financiare të debitorit, me gjasë që debitori të bankrotoj apo të riorganizohet financiarisht. Mos pagesa apo gabimi në pagesa të cilat (vonohen më shumë se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arketueshmet tregëtare janë dëmtuar. Shuma e provizionit është diferenca në mes vlerës bartëse të të arketueshmeve dhe vlera prezente e vlerësuar e rrjedhës së parasë së ardhëshme e zbritur me normën origjinale efektive të interest. Të arketueshmet me maturim afatshkurtër nuk janë zbritur. Vlera bartëse e të arketueshmeve zvogëlohet përmes përdorimit të një kontoje për lejime dhe shuma e humbjes njihet në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me koston e shitjeve. Kur një e arketueshme tregëtare është e pa mbledhëshme shlyhet kundër kontos për lejimet e të arketueshmeve tjera dhe tregtare e që rezultatet ndikojnë në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **2.9. Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen në Bilancin e gjendjes sipas koston. Për qëllime të Pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe depozitat e pa afatizuara të mbajtura në bankë.

## **2.10. Stokset – Inventaret**

Stokset e INFRAKOS SH.A. janë kryesisht materiale dhe pjesët rezervë të cilat janë të lidhura kryesisht me funksionimin e rrjetit hekurudhor. Vlera e stokeve është vlersuar me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme, duke përdorur metodën e matjes mesatare dhe përfshin shpenzimet e kryera në përvetësimin e stokeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin ekzistues dhe gjendjen ekzistuese të tyre. Këto materiale dhe pjesë rezervë fillimisht janë regjistruar në stoke, e më pas janë shpenzuar ose kapitalizuar në momentin e instalimit.

## **2.11. Kapitali Aksionar**

Kapitali aksionar përbëhet nga vlera reale e monetare e evituar nga kontributet e aksionereve të Kompanisë. Kapitali aksionar përbëhet nga Kapitali themeltar i Kompanisë, rezervat kapitale të grumbulluara, si dhe rezultatet ekonomike të periudhave të shkuara dhe rezultati ekonomik i periudhës raportuese.



## **2.12. Rivlerësimet - Rezervat**

Rezervat fillimisht janë njohur në gjendëjen fillestare të bilancit të gjendjes si diferencë në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës të kapitalit fillestar të kontribuar nga aksioneret e Kompanisë.

## **2.13. Beneficionet e Punëtorëve**

Kompania kontribon për punëtorët e vetë në planet pas pensionimit siq janë të përshkruara nga legjislacioni i sigurimit pensional me Ligjin Nr 04/L-249 Për Sigurimin Shendetësor. Kontributet pensionale të bazura në pagat e punëtorve mbetet përgjegjësi e Kompanisë që ato të i ndal dhe të kontribon në Skemen pensionale në emer të punëtorve të vetë.. Kompania nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane në këto skema pensionale. Siq janë skemat të cilat konsiderohen si plane të caktuara për kontributet shtesë pensionale. Kompania nuk ka skema të beneficioneve për punëtorët e vetë pas pensionimit të tyre.

## **2.14. Të pagueshmet të tjera dhe tregëtare**

Të pagueshmet të tjera dhe tregëtare njihen në vlerën reale të tyre, dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interest.

## **2.15. Tatimi në fitim aktual dhe tatimi i shtyrë**

Tatimi në fitim aktual kalkulohet në bazë të ligjit për tatimin real për Korporatat, konkretisht në pajtim me Ligjin Nr 05/L-029 Për Tatimin në Ardhurat e Korporatave (TAK) i cili aktualisht është në fuqi gjer në datën e bilancit të gjendjes. Tatimi në fitim i shtyrë është parashikuar në tërësi duke përdorur metodën e detyrimeve në arritjen e diferencave të përkohëshme në mes të bazës të vlerësimeve sipas ligjeve të taksave për pasuritë dhe detyrimet dhe vlerën bartëse të tyre për qëllime të prezantimit në Pasqyrat financiare konform Politikave kontabel të Kompanisë e të cilat në tërësi bazohen në SNRF-të. Tatimi i shtyrë përcaktohet duke përdorur normën e tatimit që është në fuqi deri në datën e Bilancit të gjendjes dhe pritjet të aplikohet kur pasuria e tatimit të shtyrë apo detyrimi i tatimit të shtyrë është i përcaktuashëm. Pasuritë nga tatimi i shtyrë janë njohur deri në atë masë kur fitimi i tatimor në të ardhmën është i mundshëm kundër së cilës diferencat e përkohëshme mundë të përfitohen.

## **2.16. Njohja e të ardhurës operative**

Të hyrat e Kompanisë janë kryesisht të hyra të cilat realizohen nga veprimtaria primare e Qasja në binare dhe qiraja – njihen në momentin e faturimit. Të hyrat njihen kur është e mundur që fitimet ekonomike lidhur me rrjedhjen e transaksioneve të Kompanisë dhe kur shumat e të hyrave mundë të matet besueshëm dhe kur kriteret për secilin nga aktivitetet e ndryshme të kompanisë janë përmbushur. Këto kritere të njohjes së aktiviteteve-specifike janë të bazuara në mallrat ose zgjidhjet e siguruar ndaj klientit dhe kushteve të kontratës në secilin rast, dhe janë përshkruar më poshtë

Të hyrat nga koha dhe kontratat materiale njihen sipas metodës së përqindjes së kompletimit. E hyra njihet përgjithësisht bazuar në çmimin e kontraktuar. Për kontratat e kohës, faza e kompletimit është matur në bazë të orëve të punës dorëzuar si përqindje e totalit të orëve që do të dorëzohen. Për kontratat materiale, faza e përfundimit është matur në bazë të shpenzimeve të drejtpërdrejta të shkaktuara si një përqindje e shpenzimeve totale që do të ndodhin. Të hyrat nga kontratat me çmime fikse për ofrimin e shërbimeve të transportit në përgjithësi njihen në periudhën që shërbimet janë siguruar, duke përdorur metodën drejtëvizore mbi afatin e kontratës.



Nëse lindë ndonjë rrethanë që mund të ndryshojnë vlerësimin origjinal të të hyrave, kostove ose shkallën e progresit drejt përfundimit, vlerësimet korrigjohen. Këto rishikime mund të rezultojnë në rritje apo zvogëlime në të ardhurat ose shpenzimet e vlerësuara dhe pasqyrohen në të ardhura në periudhën në të cilën rrethanat që shkaktuan inicimin e rishikimit bëhet i njohur nga menaxhmenti.

## **2.17 Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin e kryerjes së shërbimit ose në datën e faturimit.

## **2.18 Shpenzimet e huazimit**

Shpenzimet e huazimit kryesisht përbëhen nga interesi mbi huazimet e Kompanisë. Të gjitha kostot e huamarrjes, duke përfshirë koston e huamarrjes drejtpërdrejtë i atribuohet përvetësimit, ndërtimit apo prodhimit të një asemi të caktuar, janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë shkaktuar dhe raportuar në 'kostot financiare'.

## **2.19 Grantet dhe ndihmat Qeveritare**

Grantet nga qeveria janë njohur me vlerën reale ku është një siguri e arsyeshme se grantet do të mirren dhe Kompania do ti përmbush kushtet e bashkangjitura.

Grantet qeveritare lidhur me blerjen e paisjeve, pronës dhe impianteve janë të përfshira në detyrimet jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyr dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në bazë drejtëvizore sipas shkallës së zhvlerësimit për kategorinë e caktuar. Grantet qeveritare që lidhen me shpenzimet janë të shtyra dhe njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave gjatë periudhës së nevojshme që të përputhen ato me shpenzimet që ato kanë për qëllim për ti kompensuar.

## **2.20 Provizionet**

Provizionet njihen kur Kompania ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe mundësia është që një rrjedhë e burimeve të shoqëroj beneficinet ekonomike që do të jenë të kërkuara të vendoset obligimi. Provizionet janë rishikuar në ç' do datë të Bilancit të gjendëjes dhe janë regulluar ashtu që të reflektoi parashikimet më të mira të tanishme.

Kur ndikimi i vlerës në kohë të parasë është material, shumat e provizionit paraqesin vlerat e tanishme të shpenzimeve të pritura që do të kërkojnë të vendoset obligimi.

## **2.21 Pasuritë dhe Detyrimet e kushtëzuara (kontigjente)**

Pasuritë dhe Detyrimet e kushtëzuara nuk janë njohur në Pasqyrat financiare. Ato shpalosen veq nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që shoqëron beneficinet ekonomike është e afërt. Pasuria e kushtëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur ardhëja e beneficioneve ekonomike është e mundëshme. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provision nëse është e mundëshme që ngjarjet e ardhëshme do ta konfirmojnë atë detyrim në datën e Bilancit të gjendëjes dhe parashikimi është i arsyeshëm lidhur me shumën e rezultuar të humbjes që mund të bëhet.



## **2.22 Ngjarjet pas datës së Pasqyrës së bilancit**

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e Kompanisë në datën e Bilancit të gjendëjes (Ngjarjet rregullues) janë të rëfektuara në Pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë rregulluar në Pasqyrat financiare pa tjetër se janë shpalosur në shenime shpjeguese sidomos kur janë materiale.

## **3. Rreziqet e Kompanisë**

### **3.1. Rreziku financiar menaxhues**

Rreziku i menaxhimit të Kompanisë bartet nga Bordi i Drejtorëve. Rreziku i Menaxhmentit është fokusuar në pa mundësinë për të parrashikuar ecuritë e tregjeve globale, andaj dhe mundohet të i minimizoi efektet e kundërta mbi performancën biznesore të Kompanisë. Theks të posaqëm lidhur me rrezikun financiar Menaxhmenti i Kompanisë i ka vënë vetës që të gjendet metoda efektive dhe efikase për arkëtimet me kohë të të arketueshmeve të tjera dhe tregëtare nga dhënja e pronave me qira.

### **3.2 Risku i tregut**

Risku i tregut është risk që ndryshon në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit të huaj, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojë në të ardhurat e kompanisë ose vlerën titujve të instrumenteve financiare të saj. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, derisa optimizon kthimin.

### **3.3 Risku i monedhës**

Kompania për ushtrimin nën auditim nuk i është ekspozuar riskut të monedhës pasi që ka operuar vetëm në valutën Euro (EUR).

#### **Rreziku kreditor**

Kompania nuk ka koncentrim domethënse të rrezikut kreditor. Kompania ka politika të vendosura që shitja e produkteve u bëhen klientëve me një histori kreditore të pastër. Kompania mundohet të aplikoj politika të cilat në një masë i limitojnë shumat e ekspozuara të ndonjë kundër partneri. Maksimumi i ekspozimit të Kompanisë ndaj rrezikut kreditor prezantohet nga shuma bartëse për secilin mjet financiar në Bilancin e gjendëjes. Theksimet e lartëcekura janë të lidhura edhe me këtë rrezik që Menaxhmenti i Kompanisë mundohet ta zgjedh për afate të gjata dhe në perspektivë.

#### **Llogaritë e arkëtueshme tregtare**

Ekspozimi i Kompanisë ndaj riskut të kredisë është i ndikuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Ky ekspozim mund të varet nga risku i mos pagesës në industri dhe tregun e brendshëm në të cilën vepron Kompania.

Kompania krijon një lejim për dëmtimet që pasqyrojnë vlerësimet e saj të humbjeve të shkaktuara në lidhje me të arkëtueshmet tregtare, të arkëtueshmet tjera dhe investimet. Komponentët kryesorë të këtyre lejimeve janë komponentë të veçantë të humbjes që ka të bëjë me ekspozimet individuale të rëndësishme, dhe një komponentë e përbashkët e humbjes e themeluar për asetet të ngjashme të kompanisë në lidhje me humbjet që kanë ndodhur, por ende të pa identifikuar. Lejimi për humbjet e përbashkëta është përcaktuar në bazë të të dhënave historike të statistikave të pagesave për asete të ngjashme financiare.



## Analiza e riskut të kredisë

### Pauritë

|                                   | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|-----------------------------------|------------------|------------------|
| Stoqet                            | 838              | 869              |
| Llogaritë e arkëtueshme tregëtare | 2927             | 2469             |
| Paratë në arkë dhe bankë          | 41               | 627              |
|                                   | <b>3,806</b>     | <b>3,965</b>     |

### 3.5 Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjate, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parasë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë në vërtetim prej 180 ditësh dhe 360 ditësh identifikohet çdo muaj. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepëri apo ndonjë mungesë.

Më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017, detyrimet e kompanisë kishin maturitet të kontraktuar (duke përfshirë pagesat e interesit, ku është e aplikueshme) të përmbledhur si më poshtë:

### Pasuritë

|                                   | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|-----------------------------------|------------------|------------------|
| Stoqet                            | 838              | 869              |
| Llogaritë e arkëtueshme tregëtare | 2927             | 2469             |
| Paratë në arkë dhe bankë          | 41               | 627              |
|                                   | <b>3,806</b>     | <b>3,965</b>     |

### Detyrimet

|                                     | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|-------------------------------------|------------------|------------------|
| Llogaritë e pagueshme tregtare      | 1650             | 612              |
| Obligimet për tatime dhe kontribute | 765              | 223              |
| Obligimet tjera afatshkurtëra       | 205              | 205              |
|                                     | <b>2620</b>      | <b>1040</b>      |
| <b>Hapësira e likuiditetit</b>      | <b>1,186</b>     | <b>2,925</b>     |

Shumat e mësipërme pasqyrojnë rrjedhat e parave të gatshme të pa zbritura, të cilat mund të ndryshojnë nga vlerat bartëse të detyrimeve në datën e raportimit. Po ashtu të dhënat e mësipërme terheqin vëmendjen se kompania ka rrezik të lartë të likuiditetit.



### 3.6 Menaxhimi i rrezikut kapital

Objektivat e Kompanisë sa i përket menaxhimit të kapitalit janë të ruajë mundësinë që Kompania të vazhdojë vijueshmërinë në mënyrë që të siguroi kthimin e benefiteve për aksionerët dhe përfitime për aksionerët tjerë, si dhe të mirëmbaj një strukturë optimale të kapitalit për të ulë koston e kapitalit. Në mënyrë të mirëmbajtjes apo rregullimit të strukturës së kapitalit, Kompania mund ta Risë apo kthejë kapitalin te aksionerët apo dhe të i shes pasuritë që t'i ulë detyrimet e lindura me maturitet të shkurtër.

### 3.7 Parashikimi i vlerës së drejtë (fer)

Të arketueshmet tregëtare dhe tjera të Kompanisë, pasuritë likuide dhe detyrimet tjera dhe tregëtare kanë maturitet të shkurtër, si pasojë vlera e tyre bartëse korrespondon me vlerën reale të tyre.

### 4. Aktivet materiale

|                         | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|-------------------------|------------------|------------------|
| Toka                    | 10,552           | 10,552           |
| Objektet ndërtimore     | 6,947            | 7,054            |
| Pajisjet dhe makineritë | 2267             | 1607             |
|                         | <b>19,766</b>    | <b>19,213</b>    |

Toka, ndërtesa dhe infrastruktura e hekurudhës mandej paisjet, automjetet si dhe inventari janë zërat kryesor të pasurisë së kompanisë. Përmes tabelës më poshtë prezantojmë rrjedhën konsistente të kësaj pasurie:

|                                   | Toka          | Ndertesa dhe<br>infrastruktura | Makinerit    | Paisjet, auto<br>mjetet dhe<br>inventari | Gjithsejt     |
|-----------------------------------|---------------|--------------------------------|--------------|------------------------------------------|---------------|
|                                   | 000 EUR       | 000 EUR                        | 000 EUR      | 000 EUR                                  | 000 EUR       |
| <b>Kosto blerese/vlerësimi</b>    |               |                                |              |                                          |               |
| <b>Me 01 Janar 2017</b>           | <b>10,552</b> | <b>15,676</b>                  | <b>5,131</b> | <b>543</b>                               | <b>31,902</b> |
| Shtesat                           | 0             | 90                             |              | 11                                       | 101           |
| Zvoglimet                         | 0             | 0                              | 0            | 0                                        | 0             |
| <b>Me 31 Dhjetor 2017</b>         | <b>10,552</b> | <b>15,766</b>                  | <b>5,131</b> | <b>554</b>                               | <b>32,003</b> |
| Shtesat                           | 0             | 405                            | 1,249        | 6                                        | 1,660         |
| Zvoglimet                         | 0             | 0                              | 0            | 0                                        | 0             |
| <b>Gjendja me 31 Dhjetor 2018</b> | <b>10,552</b> | <b>16,171</b>                  | <b>6,380</b> | <b>560</b>                               | <b>33,663</b> |
| <b>Zhvlerësimi akumuluar</b>      |               |                                |              |                                          |               |
| <b>Me 01 Janar 2017</b>           | <b>0</b>      | <b>7,952</b>                   | <b>3,304</b> | <b>395</b>                               | <b>11,651</b> |
| Zhvlerësimi për vitin             | 0             | 636                            | 459          | 42                                       | 1,137         |
| <b>Më 31 Dhjetor 2017</b>         | <b>0</b>      | <b>8,588</b>                   | <b>3,763</b> | <b>437</b>                               | <b>12,788</b> |
| Zhvlerësimi për vitin             | 0             | 636                            | 434          | 39                                       | 1,109         |
| <b>Më 31 Dhjetor 2018</b>         | <b>0</b>      | <b>9,224</b>                   | <b>4,197</b> | <b>476</b>                               | <b>13,897</b> |
| <b>Shuma e mbetur</b>             |               |                                |              |                                          |               |
| <b>Me 31 Dhjetor 2018</b>         | <b>10,552</b> | <b>6,947</b>                   | <b>2,183</b> | <b>84</b>                                | <b>19,766</b> |

Ndertesat dhe infrastruktura janë zhvlerësuar me normën 5% sipas politikave të kompanisë mbi vlerësimin për jetën e përdorimit të ndërtesës.

Makineritë janë zhvlerësuar me normën 10%.

Automjetet, paisjet dhe inventari janë zhvlerësuar me normën 20% sipas politikave të kompanisë mbi zhvlerësimin.

**Shenim:** Me datën 31 Dhjetor 2018, nuk ka ndonjë artikull të pronës, makinerive, automjeteve dhe paisjeve të lënë peng si garancion në ndonjë fond apo për ndonjë kredimarrje.

## PASURITË QARKULLUESE

### 5. Stoqet

|                                | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|--------------------------------|------------------|------------------|
| Depoja e pjesëve rez. nga BKK  | 425              | 456              |
| Nafta                          | 2                | 3                |
| Depoja kryesore/HU             | 12               | 14               |
| Loco depo/HU                   | 36               | 37               |
| Depo vajrave dhe lyerseve etj. | 2                | 2                |
| Depoja e SS dhe TK/HU          | 357              | 353              |
| Depoja e binareve/HU           | 3                | 3                |
| Depo ne stacion                | 3                | 2                |
|                                | <b>838</b>       | <b>869</b>       |

Stoqet janë paraqitur me çmimin më të ulët ose në vlerën e realizueshme neto. Shpenzimet e shkaktuara gjatë vendosjes së secilit zë të stoqeve në vendin e tyre të tanishëm dhe konditat janë llogaritur për lëndë të parë dhe për të mira konsumuese si çmim i blerjes sipas metodës së vlerës mesatare.

Vlera e realizueshme neto është lartësia e çmimit të kalkuluar në shpenzimet e zakonshme të biznesit, duke zbritur shpenzimet e kalkuluar të vlerës përfundimtare dhe shpenzimet e llogaritura të nevojshme për kryerjen e shitjes.

Provizionet përkatëse të bazuara në përlllogaritjet e drejtimit janë bërë për të reflektuar zbritjen e vlerës së stoqeve për shkak të vjetërsisë.

### 6. Të arkëtueshmet

|                                        | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|----------------------------------------|------------------|------------------|
| Transporti i mallrave                  | 25               | 19               |
| Qiraja                                 | 2,340            | 2,042            |
| Kërkesat të tjera                      | 1,377            | 1,149            |
| Proviz.per borxh.e këqija              | - 815            | -741             |
| <b>Gjithësejt te arketueshmet Neto</b> | <b>2,927</b>     | <b>2,469</b>     |



Llogaritë e arkëtueshme mbahen në llogari të veçanta për çdo konsumator për shërbimet tjera që ofron kompania dhe ato paraqiten me vlerën e pritshme të realizuar dhe njihen atëher kur të hyrat ndodhin respektivisht pranohen si të tilla nga blerësit. Provizionimi i të arketueshmeve tjera dhe tregëtare gjate viti 2018 ka qene në vlerë 75,012.00 euro.

## 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

|                          | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|--------------------------|------------------|------------------|
| Paratë në bankë dhe arkë | 41               | 627              |
|                          | <u>41</u>        | <u>627</u>       |

Teprica përfaqson parat e gatshme dhe ekzistencen e parave te gatshme dhe vlerën e tyre në fund të periudhës .

Kompania transakcionet e veta financiare i realizon edhe me banka. Transakcionet kryhen ne: Pro CreditBannkë.

## 8. Ekuiteti aksionar dhe rezervat

|                                   | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|-----------------------------------|------------------|------------------|
| Kapitali themelues(i regjistruar) | 25               | 25               |
| Rezervat e rivlerësimit           | 15,227           | 15,227           |
| Fitimet/humbjet e bartura         | -1,697           | -1,606           |
| Fitimi/humbja e vitit             | -765             | -90              |
|                                   | <u>12,790</u>    | <u>13,556</u>    |

Kapitali aksionar përbëhet nga vlera reale e monetare e evidentuar nga kontributet e aksionereve të Kompanisë. Kapitali aksionar përbëhet nga Kapitali themeltar i Kompanisë, rezervat kapitale të grumbulluara, si dhe rezultatet ekonomike të periudhave të shkuara dhe rezultati ekonomik i periudhës raportuese. Kapitali fillestar i Kompanisë me rastin e konstituimit ishte prej 25 mije Euro.

Përmes tabelës në vijim paraqesim ecurinë e kapitalit për dy periudha raportuese:

|                                    | Kapitali<br>aksionar<br>€ | Fitimet e<br>mbajtura<br>€ | Rezervat<br>e tjera<br>€ | Gjithsej<br>€  |
|------------------------------------|---------------------------|----------------------------|--------------------------|----------------|
| <b>Gjendja më 1 janar 2017</b>     | <b>25</b>                 | <b>-1,607</b>              | <b>15,227</b>            | <b>13,645</b>  |
| Fitimi / (humbja) i/e vitit        | -                         | - 90                       |                          | 90             |
| Diferencat nga përkthimet valutore | -                         | -                          | -                        | -              |
| Dividendat                         | -                         | -                          | -                        | -              |
| Deponimet e kapitalit shtesë       | -                         | -                          | -                        | -              |
| Ndarja e rezervave                 | -                         | -                          | -                        | -              |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>  | <b>25,</b>                | <b>-1,696</b>              | <b>15,227</b>            | <b>13, 556</b> |
| <b>Gjendja më 01.01.2018</b>       | 25                        | -1,697                     | 15,227                   | 13,555         |
| Fitimi / (humbja) i/e vitit        | -                         | - 765                      |                          | 765            |
| Diferencat nga përkthimet valutore | -                         | -                          | -                        | -              |
| Dividendat                         |                           |                            |                          |                |
| Deponimet e kapitalit shtesë       |                           | -                          | -                        |                |
| Ndarja e rezervave                 | -                         | -                          |                          |                |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>  | <b>25</b>                 | <b>-2,462</b>              | <b>15,227</b>            | <b>12,790</b>  |

Grantet Qeveritare dhe Donacionet për shpenzimet operationale dhe investimet kapitale janë të përfshira në detyrime jo qarkulluese si Grant Qeveritar dhe Donacione të shtyra dhe janë kredituar në Pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve në parimin drejt-vizorë bazuar në jetën e pritur të pasurisë përkatëse.

Po ashtu për ushtrimin nën auditim, kompania ka pranuar Subvencione nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mjete të gatshme në vlerë 600,000 euro.

## 9. Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

|                                          | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|------------------------------------------|------------------|------------------|
| Llogaritë e pagueshme tregtare           | 1,650            | 612              |
| Obligimet për tatime dhe kontribute      | 765              | 223              |
| Obligimet tjera afatshkurta              | 205              | 205              |
| <b>Gjithsejt detyrimet afatshkurtera</b> | <b>2,620</b>     | <b>1,040</b>     |

Llogarit e pagueshme (detyrimet) janë vlerësuar për nga vlera e tyre nominale dhe periudha kohore e tyre dhe ju takojnë detyrimeve për mallërat e blera, shërbimet e kryera ndaj kompanisë. Detyrimet ndaj furnitorve janë regjistru si neto e zbritjeve komerciale; Zbritjet njihen në kohën e pagesës. Vlera nominale e këtyre detyrimeve është rregulluar, në rastet e kthimit dhe lejimit (rregullimit të faturimit), në proporcion me shumën e definuar me palen tjetër.

Obligimet për tatime dhe kontribute ju përkasin: obligimet për tatime dhe kontribute në paga për muajin dhjetor 2018, të cilat duhet të paguhet deri më datën 15 të muajit paraardhës, detyrimet tjera tatimore ju përkasin obligimeve tatimore që kompania ka nga vitet e kaluara, ndërsa tvsh (171,110€) e faturueshme është obligim i cili krijohet ndaj tvsh-së gjatë faturimit për konsumator



## 10. DETYRIMET AFATGJATA

|                               | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|-------------------------------|------------------|------------------|
| Grantet e shtyra qeveritare   | 7,904            | 8,123            |
| Detyrimet e shtyera tatimore  | 258              | 395              |
| Gjithsejt detyrimet afatgjata | <u>8,162</u>     | <u>6,518</u>     |

## 11. Të ardhurat

|                                                   | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|---------------------------------------------------|------------------|------------------|
| Të ardhurat nga shfrytëzimi i rrjetit - TM        | 97               | 98               |
| Të ardhurat nga shfrytëzimi i rrjetit - TU        | 307              | 427              |
| Të ardhurat nga qiraja                            | 647              | 653              |
| Të ardhurat tjera                                 | 298              | 285              |
| Të ardhurat e shtyra nga grantet BK               | 915              | 949              |
| Të ardhurat nga subvencionit per mbul. Tarifa BKK | 587              | 756              |
| Te hyrat nga grantet dhe subvencioneve            | 0                | 578              |
|                                                   | <u>2,851</u>     | <u>3,746</u>     |

Të ardhurat kryesisht janë krijuar nga shfrytëzimi i rrjetit hekurudhor per transportin e mallerave, nga shfrytëzimi i rrjetit hekurudhor per transportin punetoreve, te ardhurat nga qiraja dhe te ardhurat tjera për të gjithë konsumatorët, pavarësisht statutin e tyre juridik: persona fizik, biznese, institucione vendore dhe nderkombëtare.

Për ushtrimin nën auditim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka dhënë subvencione në vlerë 600,000.00 euro. Nga evidencat e paraqitura nga kompania, rezulton se këto subvencione janë dhënë për: shpenzimet e transportit per kompeznimin e diferencës per çmimet qe ka ul qeveria si dhe per investime kapitale..

## 12. Shpenzimet operative

Shpenzimet kanë ndodhë nga zhvillimi i aktiviteteve operuese të kompanisë. Pranohet në relacion me destinimin funksional të shpenzimeve te natyrës te mbetur (tepricave). Në vijim shpalosen më detalisht këto shpenzime:

### Shpenzimet e personelit

|                                                          | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|----------------------------------------------------------|------------------|------------------|
| Pagat bruto per personelin                               | 1,979            | 2,001            |
| Kontributet pensionale nga Punëdhënësi për të punësuarit | 100              | 102              |
| Pagat e Bordit te Drejtorve                              | 25               | 25               |
|                                                          | <u>2,104</u>     | <u>2,128</u>     |

Shpenzimet për personel-Artikulli i mbulon koston e plotë të punonjësve duke përfshirë përmirësimet e meritave, lëvizjes në mes kategorive, shpenzimet e paparashikuara, kostoja e pushimeve të pa shfrytëzuara dhe dispozitat e ligjit.

Numri i të punësuarve më 31 dhjetor të ushtrimit nën auditim ka qenë: 311 të punësuar ndërsa për vitin paraprak 323 të punësuar .

#### Shpenzimet e zhvlerësimit

|                                                        | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|--------------------------------------------------------|------------------|------------------|
| Zhvlersimi i ndertesave, inifrstruktues dhe makinerise | 1,109            | 1,137            |
|                                                        | <b>1,109</b>     | <b>1,137</b>     |

Sa i përketë zhvlerësimit specifikohet që të njëjtat janë kalkuluar në bazë të jetës së dobishme të aktiveve dhe shfrytëzimit të tyre në gjatësinë e përdorimit.

#### Shpenzimet operative (vazhdim)

|                                            | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|--------------------------------------------|------------------|------------------|
| Shpenzimet e Pajisjeve                     | 17               | 5                |
| Shpenzimet e lokaleve. (ndërtesave)        | 21               | 26               |
| Shpenzimet e Energjise Elektrike           | 119              | 131              |
| Mirëmbajtjet e naftës                      | 47               | 41               |
| Mirëmbajtjet e vajrave, lyersit etj.       | 0                | 1                |
| Mirëmbajtjet e materialit/hargj.operat     | 30               | 31               |
| Kostoja e riparimeve                       | 17               | 9                |
| Kostot e Shërbimeve Operative              | 1                | 4                |
| Kostot e Udhëtimet zyrtare                 | 9                | 10               |
| Kostot për Marketing dhe Publikimet        | 7                | 2                |
| Kostot për Material të zyre dhe Konsum.    | 11               | 11               |
| Kostot e Telefonit dhe Mail/Internet       | 19               | 23               |
| Shp.e Rrezikshmërisë                       | 6                | 7                |
| Shpenzimet e Reprezentacionit./konsumueset | 9                | 8                |
| Shpenzimet e sigurimit                     | 9                | 61               |
| Shpenzimet për stafin e jashtëm            | 2                | 1                |
| Shpenzime Tjera Operative                  | 79               | 197              |
| Shpenzimet Financiare Art.                 | 1                | 1                |
|                                            | <b>404</b>       | <b>569</b>       |



### 13. Fitimi/humbja para tatimeve

|                              | 2018<br>Euro'000 | 2017<br>Euro'000 |
|------------------------------|------------------|------------------|
| Fitimi / Humbja para tatimit | -765             | -90              |
|                              | <b>-765</b>      | <b>-90</b>       |

Pas zbritjes të gjitha shpenzimeve, vërehet se kompanija ka paraqitur rezultat negativ financiarë në vlerë -765K euro.

### 14. Tatimi në të ardhurat e korporatave

Harmonizimi i shpenzimeve të tatimit në të ardhurat e korporatave i zbatueshëm për profitin nga aktivitetet operative para zbritjes së tatimit në të hyra, sipas shkallës ligjore për tatimin në të hyra ndaj shkallës së zbatueshme të tatimit në të hyra të ndërmarrjes për vitet e përfunduara më 31 dhjetor është si në vijim:

| Përshkrimi                                    | Vlera në € |
|-----------------------------------------------|------------|
| E ardhura/humbja para tatimit                 | -765       |
| Shtimi me rregullime                          |            |
| Zvoglimi me rregullime-kontributet humanitare | 0          |
| Baza për llogaritjen e tatimit                | -765       |
| Shkalla tatimore                              | 10%        |
| Obligimi tatimor                              | 0.00       |
| Kestet e paguara gjate vitit                  | 0.00       |
| Ma pakë paguar                                | 0.00       |
| Ma tepër paguar                               | 0.00       |

Nga të dhënat e prezentuara në tabelën lartë vërehet se kompania nuk ka pasë obligime për ushtrimin nën auditimin ndaj tatimit në të ardhurat e korporatave, pasi që ka afaruar me rezultat negativë financiarë dhe është e liruar nga tatimi në të ardhurat e korporatave sipas kërkesave të rregullave për tatime.

Rregullat e nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-29 Për tatimin mbi të ardhurat e Korporatave e rregullojnë materjen për tatimet në të ardhura dhe përcaktojnë që shkalla e tatimit është 10%.

Sipas rregullave të nenit 23 pika 2 të Ligjit Nr. 05/L-29 Për tatimin mbi të ardhurat e Korporatave, humbja tatimore mund të bartet në gjashtë(6) periudhat të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

Autoritetet tatimore nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje gjate vitit ushtrimor për librat dhe shënimet e ndërmarrjes për tatimet në të ardhurat e korporatave deri në kohën e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2018.

Tatimet shtesë ose ndëshkimet që mund të arkëtohen në rast të një auditimi tatimor, nuk mund të përcaktohen në këtë moment me ndonjë saktësi të arsyeshme.

### 15. Pasuritë dhe detyrimet e kushtëzuara (kontigjente)

Sipas Raportit Vjetor Financiar 2018, për ushtrimin nën auditim kompania ka qenë edhe palë e paditur si dhe palë paditëse..

## **16. Ngjarjet pas datës së Bilancit**

Drejtimi i kompanisë nuk ka prezentuar ndonjë rastë që mundë të ketë ndikim në pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor të vitit 2018.

## **17. Parimi i Vijimësisë**

NP Infrakos subvencionohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik për të financuar (mbuluar) projektet për investime kapitale, mirëpo edhe përkundër kësaj infrastrukture e Hekurudhave në Kosovë është në gjendje të vështirë dhe paraqet një problem mjaft të madh për vendin tonë. Për shkak të vështërsive të afarizmit, NP Infrakos ka operuar me humbje financiare ku shpenzimet e përgjithshme janë më të larta se të hyrat operative. Bordi i drejtorëve duhet të jetë më aktiv për të shqyrtuar të gjitha aktivitetet e kryera nga menaxhmenti krahas rezultateve të arritura.

*Shtojcë: PF 2018 sipas Udhëzimit Administrativ 3/2013.*



Emri i kompanisë: **INFRAKOS SHA**

Numri fiskal: **600281399**

Adresa: **Sheshi i Lirisë, pn**

Komuna: **Fushë Kosovë**

## RAPORTI FINANCIAR VJETOR PËR SHOQËRITË TREGTARE

### I. BILANCI I GJENDJES

Për periudhën 01-01-18 deri 31-12-18

| Shenja e zërit | Emërtimi i zërit                                                   | Nr.i shënimit | Shumat në euro               |                                |
|----------------|--------------------------------------------------------------------|---------------|------------------------------|--------------------------------|
|                |                                                                    |               | Viti vijues<br>(në euro 000) | Viti i kaluar<br>(në euro 000) |
|                | <b>PASURITË</b>                                                    |               |                              |                                |
| <b>A</b>       | <b>KAPITALI I THIRRUR I PAPAGUAR</b>                               |               |                              |                                |
| <b>B</b>       | <b>PASURITË JOQARKULLUESE (I+II+III+IV)</b>                        |               | <b>19,766</b>                | <b>19,213</b>                  |
| <b>I</b>       | <b>PASURITË E PAPREKSHME (1 deri 4)</b>                            |               | <b>0</b>                     | <b>0</b>                       |
| 1              | Kostot e zhvillimit                                                |               |                              |                                |
| 2              | Patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera |               |                              |                                |
| 3              | Emri i mirë (Goodwilli)                                            |               |                              |                                |
| 4              | Pasuritë tjera të paprekshme                                       |               |                              |                                |
| <b>II</b>      | <b>PASURITË E PREKSHME (1 deri 7)</b>                              | <b>3</b>      | <b>19,766</b>                | <b>20,250</b>                  |
| 1              | Toka                                                               |               | 10,552                       | 10,552                         |
| 2              | Objektet ndërtimore                                                |               | 6,947                        | 7,054                          |
| 3              | Pajisjet dhe makineritë                                            |               | 2,267                        | 1,607                          |
| 4              | Veglat, inventari i reparit dhe mjetet transportuese               |               |                              |                                |
| 5              | Pasuritë biologjike                                                |               |                              |                                |
| 6              | Pasuritë tjera të prekshme                                         |               |                              |                                |
